

**AKT THEMELIMI**  
**SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ElektroEdi”**

Sot në Tiranë, më 05.08.2024, bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tim të lirë, jam shprehur në nënshkrimin si ortak themelues dhe deklaroj se kam përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar “**ElektroEdi**”.

Unë ortaku i vetëm Edmond DEMUÇAJ, i datëlindjes 12.05.1984, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimin me numër personal I40512114R, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

**THEMELIMI**

**Neni 1**

Themelohet Shoqëria tregtare “ElektroEdi” SHPK, e cila do ti nënshtron legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

**SELIA E SHOQËRISË**

**Neni 2**

Selia e shoqërisë tregtare “ElektroEdi” SHPK do të jetë në adresën: Rruga Luftëtarë i Lirisë, Nd.11, Kamëz, Valias i Ri, 1030

**Neni 3**

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridikcionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit.

Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj. Njësitet vartëse të shoqërisë jashtë shtetit do të krijohen nëse kjo e drejtë parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

**OBJEKTI I SHOQËRISË**

**Neni 4**

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar Aktivitetin e saj tregtar me objekt:

Punime elektrike për instalimin e sistemeve elektrike në të gjitha llojet e ndërtimesave dhe të strukturave inxhinierike. Shitje dhe blerje artikuj elektrik. Lidhja dhe kabllimi i pajisjeve elektrike, telekomunikacionit, rrjetit kompjuterik dhe televiziv, përfshirë fibrat optike. Vendosja e sistemeve të ndriçimit, të alarmit, të mbrojtjes nga zjarri të kamerave dhe sistemeve elektronike kundër vjedhjeve. Lidhja e montimi i pajisjeve elektroshëpiake si dhe pajisjeve të tjera shtëpiake.

**Neni 5**

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes së mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.

**KAPITALI I SHOQËRISË**

**Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 Lekë (Njëqind mijë Lekë). Ky kapital formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë

**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**



### **Neni 7**

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

### **DREJTIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 8**

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "ElektroEdi" SHPK do të drejtohet nga Administratori i saj z. Edmond DEMUÇAJ për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të emerojë një administrator tjetër, nëse e gykon të nevojshme.

### **Neni 9**

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë

### **Neni 10**

Shoqëria tregtare "ElektroEdi" SHPK do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

### **Neni 11**

Shoqëria tregtare "ElektroEdi" SHPK deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjisacionit shqiptar në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në gjuhën shqipe dhe miratohet prej Ortakut të Vetëm, duke u nënshkruar si më poshtë:

### **THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE**

"ElektroEdi" SHPK

ORTAKU I VETËM

Edmond DEMUÇAJ

*Edmond Demuçaj*

